



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Mr. Ardiana Bunjaku

Kryetare e Këshillit Drejtues të UP

Nr. Prot.: 4/225

Datë: 14 / 11 / 2018

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", pas shqyrtimit të kërkesës nr. 4/343, të datës: 19 tetor 2018, të parashtruar nga prof. asoc. dr. Sadik Zekaj, ish mësimdhënës në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës, për kompensim të pagave pas pensionit. Në mbledhjen e mbajtur me 25.10.2018, merr këtë:

V E N D I M

- I. Prof. asoc. dr. Sadik Zekaj, ish mësimdhënës në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" tani i pensionuar me vendimin e nr. prot. 456 të datës: 01 mars 2018, i REFUZOHET kërkesa për kompensimin e pagave pas pensionimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit dhe është përfundimtar për organet e UP-së.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 25.10.2018, pasi shqyrtoi kërkesën nr. 4/343, të datës: 19 tetor 2018, të parashtruar nga prof. asoc. dr. Sadik Zekaj, ish mësimdhënës në Fakultetin e Mjekësisë për kompensimin e tri pagave jubileare dhe tri pagave për përcjellje pas pensionimit, ku i përmenduri ka arritë moshën e pensionimit më 29 janar 2018, të cilit në bazë të vendimit të Qeverisë nr. 03/13 dt: 27.03.2008, ju është vazhduar kontrata deri në përfundim të vitit akademik gjegjësisht deri më 30 shtator 2018. KD-konsideroi se kontrata kolektive nuk ka karakter obligativ dhe atë duke u mbështetur në praktikën e institucioneve të tjera shtetërore të cilat nuk e kanë zbatuar asnjë herë kontratën kolektive të punës, sepse një kontratë e tillë e nënshkruar në mes partnerëve social ka kërkuar edhe ndarjen e kostos së lartë buxhetore, të cilën qeveria e Kosovës nuk e ka paraparë për as një institucion.

Prof. asoc. dr. Sadik Zekaj, ish mësimdhënës në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në bazë të vendimit të UP-së me nr. prot: 456, datë: 01 mars 2018, është njoftuar për moshën e pensionimit. Në atë vendim nuk është përcaktuar se a do t'i takojë drejta e kompensimit pas pensionimit sipas kontratës së përgjithshme Kolektive, sepse Kontrata Kolektive nuk ka gjetur zbatim tek as një institucion publik e po ashtu Qeveria e Rep. Kosovës nuk ka paraparë as vazhdimin e saj përkatësisht nga viti 2015-2018, e po ashtu Stafit akademik duke pasur parasysh që zgjidhet me akte të veçanta që funksion UP-ja, të njëjtit i përgjigjen atyre, andaj UP-ja ka kryer të gjitha detyrimet sipas kontratës që ka pasur e po ashtu të njëjtit ju ka paguar edhe 7 muaj paga me të drejta të barabarta sipas vendimit të lartcekur nga Qeveria. Nga kjo rezulton se menaxhment i UP-së nuk është nënshkruar i atyre kontratave dhe për këtë nuk janë kategori e barabartë sikur të punësuarit tjerë në institucione tjera publike.

Për shkak të karakterit që kanë kontratat kolektive lidhen për kohë të caktuar dhe atë më së shumti për periudhën deri në tri vjet. Prandaj afati i Marrëveshjes Kolektive ka skaduar për implementim, palët të cilat e kanë lidhë kontratën mund që me marrëveshje ta zgjasin afatin e vlefshmërisë së kontratës ose që të lidhin kontratë të re.

Nga kjo rezulton se në kohën kur prof. Sadik Zekaj është pensionuar, kontrata kolektive nuk ka pasur fuqi juridike sepse afatëshmeri i ka përfunduar me 1 janar 2018, ndërsa prof. Zadikaj është pensionuar me datë 1 mars 2018, me këtë mund të thuhet se nuk ka efekt retroaktiv e njëjta kontratë që ju ka referuar profesori në kërkesë.

Andaj Njëri nga partneret social e që është Oda Ekonomike e Kosovës, është tërhequr tre muaj më herët para se të përfundoj marrëveshja e kësaj kontrate, me arsyetimin se palët nënshkrues nuk kanë gjetur zbatimin e saj. Me këtë rast edhe ligji e parasheh se ndonjëri nga palët nënshkruese tërhiqet atëherë nuk mund të zbatohet ajo kontratë.

Prova 4: *Shkresa nga OEK drejtuar Qeverisë së Rep. Kosovës përkatësisht MPMS me nr. 392 datë 15.09.2017 dhe*

Prova 5: *Shkresa nga Këshilli Drejtues i Odës Ekonomike të Kosovës me nr. 783 dt: 12.12.2014*

Procedurat për lidhjen e Marrëveshjes së re Kolektive, mund të fillojnë më nismën e cilësdo pale kontraktuese, së paku tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së Marrëveshjes Kolektive, kjo do të thotë se negociatat për lidhje të Kontratës së re Kolektive mund të fillojnë në çdo kohë dhe moment, kur njëri nga partneret social inicion propozimin për lidhjen e Marrëveshjes së re Kolektive, e me së paku tre(3) muaj para skadimit të afatit tre(3) vjeçar, afat kohor në të cilin me së shumti mund të jetë e aplikueshme Marrëveshja Kolektive. Prandaj në kohën kur pala ka arrit moshën e pensionimit është përfunduar afatëshmeria e kontratës kolektive dhe as një nga palët nuk mund të kompensohen për pagat e referuara pasi që pala ka dalë në pension në mars të vitit 2018 ndërsa afatshmeria e kontratës ka qenë deri në vitin 2008. Mbi këtë bazë dhe nga ajo që u tha më lartë KD- mori këtë vendim.

Vendim t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Parashtruesit të Kërkesës,
3. Shërbimit financiar të F. Mjekësisë,
4. Zyrës Ligjore të UP.
5. Asistentes së KD-së



Këshilli Drejtues i UP-së

Mr. Ardiana Bunjaku - Kryesuese